

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj

**Pasqyrat Financiare
per periudhen nga 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016**

PERMBAJTJA:	FAQJA
RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE	
TE TJERA PERMBLEDHESE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	5
PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE	6
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	7-22

RAPORT I AUDITUESVE TE PAVARUR

Drejtuar: Asamblese se Aksionereve te Shoqerise
"BRUNEL ENERGY EUROPE B.V. Dege e Shoqerise se Huaj"

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "BRUNEL ENERGY EUROPE B.V. Dege e Shoqerise se Huaj", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2016, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (*Kodi i BSNEPK*) së bashku me kërkesat etike dhe ligjore që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Ne nuk kemi përcaktuar ndonjë çështje si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.


Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.


Elton MERSINI
Auditues Ligjor

Adresa:
Lagjja: Sul Papri, Pallati 134, Sh 1, Ap 14
Elbasan, ALBANIA


Edi STAJA
Auditues Ligjor

Adresa:
Lagjja: 28 Nëntori, Rr: Abdyl Frashëri, Nr 28,
Elbasan, ALBANIA

Date: 30 Mars 2017

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj
Pasqyra e Pozicionit Financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shenimet	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktivitet			
Aktivitet Afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	5	270,862,211	128,955
Llogari te arketueshme dhe kredi te tjera tatimore	6	16,870,874	672,297
Tatimi mbi fitimin i arketueshem	7	2,429,327	-
Te ardhura te perllogaritura	8	-	66,554,823
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		290,162,412	67,356,074
Aktivitet Afatgjata			
Totali i Aktiveve Afatgjata		-	-
Totali i Aktiveve		290,162,412	67,356,074
Detyrime dhe Kapitali			
Detyrime Afatshkurtra			
Llogari te pagueshme dhe detyrime tatimore	9	41,478,831	5,628,955
Shpenzime te perllogaritura	10	285,080	5,954,031
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		41,763,911	11,582,986
Detyrime Afatgjata			
Detyrime ndaj Shoqerise Meme	11	259,027,570	51,405,209
Totali i Detyrimeve Afatgjata		259,027,570	51,405,209
Totali i Detyrimeve		300,791,481	62,988,195
Kapitali			
Fitim i pashpermdare		4,367,880	
Fitimi (Humbja) i/e periudhes		(14,996,950)	4,367,880
Totali i Kapitalit		(10,629,070)	4,367,880
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit		290,162,412	67,356,075

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Brunel Energy Europe B.V- Dege e Shoqerise se Huaj me 28.03. 2017 dhe u nenshkruan nga:

Perfaqesuesi Ligjor

Brunel
access to excellence

Brunel Albanian Branch – Brunel Energy Europe B.V,
 Dege e Shoqerise se Huaj
 L51816004Q
 Rruga "Elbasanit", Pallati nr.1, kati 2, Tirane, Shqiperi
 Albania
 ssc.europe@brunel.net

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera permbledhese per periudhen
nga 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK)

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA
PERMBLEDHESE

	Shenimet	Per periudhen nga data 1 janari 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Te ardhurat			
Te ardhura nga sherbimet	12	189,276,405	66,554,822
Te ardhura te tjera	12	315,326	-
Totali i te ardhurave		189,591,731	66,554,822
Shpenzimet			
Shpenzime personeli	13	(154,813,025)	(52,509,524)
Shpenzime operative	14	(29,564,608)	(8,639,105)
Totali i shpenzimeve		(184,377,634)	(61,148,629)
Fitimi nga aktiviteti operacional		5,214,097	5,406,194
Te ardhura dhe shpenzime financiare neto			
Te ardhura (shpenzime) financiare neto	15	(20,211,047)	26,084
Fitimi (Humbja) neto financiare		(20,211,047)	26,084
Fitimi (Humbja) per periudhen		(14,996,950)	5,432,277
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	16	-	1,064,397
Fitimi (Humbja) per periudhen		(14,996,950)	4,367,880
Te ardhura te tjera permbledhese per periudhen		-	-
Totali i te ardhurave permbledhese per periudhen		(14,996,950)	4,367,880

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera permbledhese duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaaj
Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto per periudhen 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

	Totali
Gjendja ne daten e themelimit 18 maj 2015	-
Fitimi neto i periudhes	4,367,880
Te ardhura te tjera permbledhese	-
Gjendja me 31 dhjetor 2015	4,367,880
Humbja neto i periudhes	(14,996,950)
Te ardhura te tjera permbledhese	-
Gjendja me 31 dhjetor 2016	(10,629,070)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaaj
Pasqyra e Rrjedhes se Parase per periudhen 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK)

PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE

		Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Rrjedha e parase nga veprimtaria e shfrytezimit	Shenimet		
Fitimi (Humbja) para tatimit		(14,996,950)	5,432,277
Rregullimet per:			
Shpenzime te tatimit mbi fitimin	16	-	(1,064,397)
Ndryshimet ne kapitalin punues:			
Rritje ne llogari te arketueshme dhe kredi te tjera tatimore	6	(16,198,577)	(672,297)
Renie ne te ardhura te perlogaritura	8	66,554,823	(66,554,823)
Rritje ne llogari te pagueshme dhe detyrime tatimore	9	35,849,876	5,628,955
Renie ne shpenzime te perlogaritura	10	(5,668,951)	5,954,031
Paraja e gjeneruar nga veprimtarite e shfrytezimit		65,540,220	(51,276,253)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(2,429,327)	-
Paraja neto e gjeneruar nga veprimtarite e shfrytezimit		63,110,893	(51,276,253)
Rrjedha e parase nga (perdorur ne) veprimtarite investuese			
Paraja e gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtarite investuese		-	-
Rrjedha e parase nga veprimtarite financuese			
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	11	207,622,362	51,405,209
Paraja e gjeneruar nga veprimtarite financuese		207,622,362	51,405,209
Rritja neto e mjeteve monetare		270,733,256	128,955
Mjetet monetare ne fillim te periudhes	5	128,955	-
Mjetet monetare ne fund te periudhes	5	270,862,211	128,955

Pasqyra e Rrjedhes se Parase duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj (referuar ne vijim si “Dega”) eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne daten 18 maj 2015, si dege e shoqerise se huaj, e cila vepron sipas Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar.

Perfaqesues ligjore te Shoqerise jane Z. Johan Hardy Flohr dhe Z. Johannes Adriaan de Vries, te dy shtetas hollandeze. Shoqeria Meme eshte **Brunel Energy Europe B.V.**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me kapital ne shumen 18,000 Euro e themeluar ne Hollande me 20 shkurt 2003.

Objekt i veprimtarise se Deges eshte te ofroje sherbime dhe keshillime per sipermarrjet industriale, vecanerisht sipermarrjet qe ushtrojne veprimtari ne fushen e industrise se vajit dhe gazit, kimise, industrise petrokimike dhe industrise se energjise.

Aktualisht Dega ka nje marredhenie kontraktuale me Trans Adriatic Pipeline AG, Dega ne Shqiperi (ketej e tutje referuar si “TAP”) dhe me Technip Italy S.p.A, Dega ne Tirane (ketej e tutje referuar si “Technip”).

Dega pergatit dhe harton pasqyrat financiare sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar ne perputhje me Ligjin nr. 9228, date 29.04.2004, “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Dega me 31 dhjetor 2016 ka patur 6 punemarres.

2. BAZA E PERGATITJES

(a) Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike. Vlerat ne pasqyrat financiare bashkangjitur jane te shprehura ne monedhen LEK, e cila eshte monedha funksionale e Deges.

(c) Standarte dhe Interpretime ne fuqi per periudhen raportuese

Ndryshimet e meposhtme te standarteve ekzistuese te publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare jane ne fuqi per periudhen raportuese:

- **Ndryshime ne SNK 19 “Perfitimet e punonjesve”** – Skemat e perfitimeve te percaktuara: Perfitimet e punonjesit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2014);

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)

(c) Standarte dhe Interpretime ne fuqi per periudhen raportuese (vazhdim)

- **Ndryshime ne disa standarte “Permiresime te SNRF-ve (2010-2012)”** qe rezultojne nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe sqarimin e fjaleve (ndryshimet duhet te aplikohen per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2014);
- **Ndryshime ne disa standarte “Permiresime te SNRF-ve (2011-2013)”** qe rezultojne nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF13, SNK 40) kryesisht me qellim eliminimin e mosperputhjeve dhe sqarimin e fjaleve (ndryshimet duhet te aplikohen per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2014);
- **Ndryshime ne SNRF 10 “Pasqyrat financiare te konsoliduara”, SNRF 12 “Dhenia e informacioneve shpjeguese per perfshirje me entitete te tjera” dhe SNK 28 “Investimet ne pjesemarrje dhe sipermarrje te perbashketa”** – Subjektet e investimeve: Aplikimi i Perjashtimit nga Konsolidimi (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2016);
- **Ndryshime ne SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** – Dhenia e informacioneve shpjeguese (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2016);
- **Ndryshime ne SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale”** - Metoda e kapitalit ne pasqyrat financiare individuale (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2016);
- **Ndryshime ne disa standarte “Permiresime te SNRF-ve (2012-2014)”** qe rezultojne nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe sqarimin e fjaleve (ndryshimet duhet te aplikohen per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2016);

Keto ndryshime ne standartet dhe interpretimet ekzistuese nuk kane ndikuar ne politikat kontabel te Shoqerise.

(d) Standarte dhe interpretime ne publikim akoma jo ne fuqi

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare standartet, permiresimet dhe interpretimet e meposhtme ishin publikuar, por akoma nuk ishin ne fuqi.

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare”** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2018);
- **SNRF 15 “Te ardhura nga kontratat me klientet”** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2017);
- **SNRF 16 “Qerate”** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2019);

2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)

(d) Standarte dhe interpretime ne publikim akoma jo ne fuqi (vazhdim)

- **Ndryshime ne SNRF 10 “Pasqyrat financiare te konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime ne pjesemarrje dhe sipermarrje te perbashketa”**- Shitja apo kontributi i pasurive ndermjet nje investitori dhe bashkepunetor te tij ose sipermarrje te perbashket (hyrja ne fuqi eshte shtyre per nje kohe te papercaktuar deri kur te mbaroje projekti kerkimore mbi metodologjine e aktiveve);
- **Ndryshime ne SNK 7 “Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare”** – Dhenia e informacioneve shpjeguese (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2017);
- **Ndryshime ne SNK 12 “ Tatimi mbi te Ardhurat”** – Njohja e aktiveve tatimore te shtyra per Humbjet e perealizuara (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2017);

Dega ka zgjedhur te mos zbatoje keto standarte, rishqyrtime dhe interpretime perpara dates se tyre efektive. Dega parashikon se zbatimi i ketyre standarteve nuk do te kete impakt material ne pasqyrat financiare individuale dhe te konsoliduara ne periudhen fillestare te zbatimit nga vete natyra e limituar e transaksioneve te kryera nga Dega.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

(a) Renia ne vlere e aktiveve jofinanciare

Aktivet, te cilat jane subjekt i amortizimit, shqyrtohen per renie ne vlere kurdo qe nje ngjarje ose ndryshime ne rrethana te caktuara, tregojne se vlere e mbetur mund te mos jete e kthyeshme. Nje humbje nga renia ne vlere njihet me vleren, me te cilen vlere e mbetur e aktivitet tejkalon vleren e kthyeshme. Vlere e kthyeshme eshte vlere me e madhe midis vleres se drejte te aktiveve minus kostot e shitjes dhe vleres se perdorimit.

Per qellime te vleresimit te renies ne vlere, aktivet grupohen ne nivelet me te ulta, per te cilat ka flukse monetare qe identifikohen ne menyre te vecante (njesite gjeneruese te mjeteve monetare). Aktivitet jofinanciare qe kane rene ne vlere rishikohen per ndonje rimarrje te zhvleresimit ne cdo date raportuese.

(b) Instrumentet Financiare

Dega mban vetem instrumente financiare joderivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, hua dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare joderivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejte me pervesimin e tyre. Pas njohjes fillestare instrumentet financiare joderivative vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet ne rast se Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te Deges ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar mbarojne, ose nese Dega i transferon aktivin financiar nje pale tjetere, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktiviteti

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(b) Instrumentet Financiare (vazhdim)

financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen dega zotohet te bleje ose te shese aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Deges te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anuluar.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne llogari rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra likuide me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere, dhe perdoren nga Dega ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

Llogari te arketueshme

Kerkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara me humbjet nga renia ne vlere.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

Huamarrjet

Huamarrjet nga aksioneret dhe huamarrjet e tjera njihen fillimisht me vleren e drejte. Huamarrjet mbarten ne vijim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta financiare te tjere jo-derivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga renia ne vlere.

Metoda e interesit efektiv eshte nje metode per llogaritjen e koston se amortizuar te nje aktivi ose detyrimi financiar dhe per shperndarjen e te ardhurave ose shpenzimeve te interesit pergjate periudhes perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skonton plotesisht pagesat e ardhshme te vleresuara pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar ose, kur eshte e pershtatshme, pergjate nje periudhe me te shkurter me vleren e mbartur neto te aktivitetit ose detyrimit financiar.

Kontabiliteti per te ardhurat dhe shpenzimet financiare shtjellohet ne politiken kontabel 3(g).

Renia ne vlere e aktivitetit financiar

Nje aktiv financiar konsiderohet te jete i zhvleresuar nese nje fakt objektiv tregon qe nje ose me shume ngjarje kane patur nje ndikim negativ ne flukset e ardhshme monetare te aktivitetit. Nje humbje nga zhvleresimi i nje aktivi financiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diference midis vleres neto dhe shumes aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te skontuara me normen efektive origjinale te interesit.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(b) Instrumentet Financiare (vazhdim)

Aktivet financiare te rendesishme individualisht i nenshtrohen testimit per zhvleresim mbi baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare jane te vleresuara se bashku, ne grupe qe shfaqin te njejzat karakteristika te rrezikut te kredise. Te gjitha diferencat nga zhvleresimi njihen si fitim ose si humbje. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet mbrapsht ne qofte se kthimi mund te lidhet objektivist me nje ngjarje te ndodhur pasi humbja nga zhvleresimi eshte njohur. Kthimi njihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave.

(c) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Dega paguan kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Qeveria Shqiptare eshte pergjegjese per percaktimin e kufirit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Deges ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore te paguara

Dega njej si detyrim vleren e paskontuar te kostove te vleresuara ne lidhje me lejet vjetore qe pritet te paguhet ne kembim per sherbimin e punonjesve gjate periudhes.

(d) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

(e) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi prej llogarive ne banka dhe fitimet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit, komisionet bankare dhe humbjet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje.

(f) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur ne pasqyren e te ardhurave permbledhese.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Tatimi i shtyre perllogaritet duke perdorur metoden e detyrimit ne pasqyren e pozicionit financiar, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(f) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

raportimit financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre perlogaritet bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit. Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem te jete i disponueshem kundrejt te cilit aktivi te mund te perdoret. Aktivi tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfitim fiskal.

(g) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare te shprehura me kosto historike nuk konvertohen. Diferencat nga kurset e kembimit nga elementet monetare njihen ne te ardhurat dhe shpenzimet e periudhes kur ato shfaqen.

Kursi i kembimit ne fund te periudhes se raportimit ishte si vijon:

EURO	135.23
DOLLAR	128.17
POUNDI BRITANIK	157.56

4. VLERESIME THELBESORE KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TË VLERESIMIT TË PASIGURISË

Dega përgatit pasqyrat financiare në përputhje me SNRF, zbatimin e të cilave zakonisht kërkon gjykimin e drejtuesve gjatë vlerësimit të pozicionit financiar dhe rezultatit të Degës. Sipas SNRF, drejtimit i kërkohet të pershtase politikën kontabel me të pershtatshme për rrethanat e Degës, me qëllim që të bëjë një paraqitje sa më të besueshme të pozicionit financiar, performancës dhe flukseve monetare të Degës.

Në përcaktimin dhe zbatimin e politikave kontabel, zakonisht kërkohet gjykim për zera për të cilët zgjedhja e politikës specifike, vlerësimet ose supozimet kontabel që do të ndiqeshin, do të ndikonin materialisht në rezultatet e raportuara ose pozicionin e aktiveve neto të Degës, në rast se me vonë do të përcaktohej që një zgjedhje tjetër do të ishte më e pershtatshme. Burimet me kritike të pasigurisë detajohen si më poshtë:

i) Te ardhurat e përlogaritura për punën e kryer

Drejtimi përlogarit të ardhura për punën që është kryer por që nuk e ka faturuar tek klienti. Të ardhura të tilla varen nga aprovimi i klientit, bazuar në specifikimet e kontratës dhe rregullimet që kërkojnë për përlogaritjet e bera nga Dega kur klienti nuk pranon vlerësimin e prezantuar nga drejtimi.

ii) Përcaktimi i vlerës së drejte

Vlera e drejte e mjeteve monetare, llogarive të arketueshme dhe të pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën kontabel neto, për shkak të maturimit të tyre afatshkurter.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

5. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre me 31 dhjetor 2016 detajohen si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari rrjedhese ne Lek – Raiffeisen Bank	6,758,264	(308)
Llogari rrjedhese ne Euro – Raiffeisen Bank	184,589,218	129,522
Llogari rrjedhese ne Dollar – Raiffeisen Bank	(128)	(259)
Llogari rrjedhese ne Pound Britanik – Raiffeisen Bank	79,514,857	-
Totali	270,862,211	128,955

6. LLOGARI TE ARKETUESHME DHE KREDI TE TJERA TATIMORE

Llogarite e arketueshme dhe kredi te tjera tatimore me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari te arketueshme:		
TAP AG, Dege e Shoqerise se huaj	11,890,577	-
Technip Italy SpA, Dega ne Tirane	4,088,057	-
Brunel Italy S.r.l	312,438	-
Kredi te tjera tatimore:		
Teprice kreditore e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore	83,923	144,424
TVSH e kreditueshme	-	527,873
Te arketueshme nga punonjesit:		
Grant Puttergill	495,879	-
Totali	16,870,874	672,297

7. TATIMI MBI FITIMIN I ARKETUESHEM

Gjate vitit 2016, Dega ka parapaguar kestet mujore te tatimit mbi fitimin, vlere totale e te cilave eshte 2,429,327 Leke dhe perben gjendjen e arketueshme me 31 dhjetor 2016.

8. TE ARDHURA TE PERLLOGARITURA

Te ardhura te perllogaritura me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Te ardhura te perllogaritura:		
Sherbime te kryera deri me 31dhjetor 2016, por ende te pafaturuara	-	66,554,822

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

Totali	-	66,554,822
---------------	---	-------------------

9. LLOGARI TE PAGUESHME DHE DETYRIME TATIMORE

Llogarite te pagueshme dhe detyrime tatimore me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve:</i>		
Brunel Energy Europe B.V	21,916,636	-
Deloitte Albania Sh.p.k	2,101,880	1,481,845
Brunel Energy Holding B.V	1,324,848	-
Brunel Italy S.r.l	1,051,808	-
e Adviser Sh.p.k	318,061	-
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve:</i>		
Pagat neto	9,194,100	-
<i>Detyrime tatimore:</i>		
Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi	2,719,370	2,606,339
TVSH per t'u paguar	2,266,432	-
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	519,352	476,374
Provizione per gjoba tatimore	66,344	-
Tatimi mbi fitimin per t'u paguar	-	1,064,397
Totali	41,478,831	5,628,955

Zeri "Llogari te pagueshme dhe detyrime tatimore" perbehet nga "Te pagueshme ndaj furnitoreve" per sherbime te marra gjate vitit 2016, "Te pagueshme ndaj punonjesve" per pagat neto te muajit dhjetor 2016 te cilat jane paguar ne muajin janar te vitit 2017 dhe "Detyrime tatimore", ku perfshihen detyrimet e Deges me date 31 dhjetor 2016 per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, tatimit mbi te ardhurat nga punesimi, tatim mbi vleren e shtuar dhe gjoba tatimore, te cilat jane paguar ne janar te vitit 2017.

10. SHPENZIME TE PERLLOGARITURA

Shpenzime te perlllogaritura me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<i>Shpenzime te perlllogaritura:</i>		
Shpenzime te perlllogaritura per fatura te pamberritura	285,080	5,954,031
Totali	285,080	5,954,031

Ne llogarine "Shpenzime te perlllogaritura" Dega ka regjistruar shpenzimet qe shoqeria meme ka kryer per llogari te saj, te cilat do te rifaturohen gjate vitit 2017.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

11. DETYRIME NDAJ SHOQERISE MEME

Fondet e transferuara nga Brunel Energy Europe B.V, Shoqeria Meme me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<i>Detyrimet ndaj Shoqerise Meme:</i>		
Detyrimet ndaj Brunel Energy Europe B.V	259,027,570	51,405,209
Totali	259,027,570	51,405,209

12. TE ARDHURA NGA SHERBIMET

Te ardhurat nga sherbimet per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Te ardhurat e realizuar nga projekti	189,276,405	66,554,822
Te ardhura te tjera	315,326	-
Totali	189,591,731	66,554,822

Ne zerin “Te ardhura nga sherbimet” perfshihen te gjitha te ardhurat e gjeneruara nga sherbimet e kryera per “TAP” dhe “Technip” gjate vitit 2016.

13. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personeli per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Shpenzime per paga	151,589,183	51,434,535
Shpenzime per sigurimet shoqerore dhe shendetsore	3,223,842	1,074,989
Totali	154,813,025	52,509,524

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

Dega ka deklaruar, perllogaritur dhe paguar paga dhe kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 “Per mbledhjen e detyrueshme te

13. SHPENZIME PERSONELI (VAZHDIM)

kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore”, si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16.04.2009, mesatarisht per 5 punonjes gjate vitit 2016.

14. SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016 perbehen nga zerat e meposhtem:

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Shpenzime te pergjithshme te alokuara	15,222,690	-
Shpenzime kontabiliteti dhe konsulence fiskale	3,744,965	1,558,166
Shpenzime per personelin	3,669,779	-
Shpenzime sigurimi	1,916,486	784,288
Shpenzime udhetimi	1,893,405	3,883,598
Shpenzime menaxhimi	1,327,200	-
Shpenzime ligjore	798,674	1,377,326
Shpenzime per sherbim konsulence	316,513	-
Penalite dhe shpenzime interesash	310,021	2,205
Shpenzime akomodimi	100,544	-
Taksa vendore	67,000	14,702
Shpenzime provizioni per gjoba tatimore	66,344	-
Shpenzime bankare	61,424	7,235
Shpenzime administrative	35,444	-
Shpenzime postare	32,704	-
Shpenzime interesi	1,415	-
Shpenzime transferimi	-	990,842
Shpenzime perkthimi	-	20,743
Totali	29,564,608	8,639,105

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

15. SHPENZIME FINANCIARE NETO

Shpenzimet financiare neto rezultojne nga ndryshimet ne kurset e kembimit per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Te ardhura nga kursi i kembimit	3,302,211	26,370
Humbje nga kursi i kembimit	(23,513,258)	(286)
<i>Humbja nga kursi i kembimit</i>	<i>(20,211,047)</i>	<i>26,084</i>
Totali	(20,211,047)	26,084

16. SHPENZIME TE TATIMIT MBI FITIMIN

Dega nuk ka shpenzim te tatimit mbi fitimin per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016 duke qene se rezulton me humbje ushtrimore dhe humbje fiskale si me poshte:

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016
Humbje e periudhes perpara tatimit	(14,996,950)
<i>Shpenzime te panjohura</i>	<i>6,081,850</i>
Fitimi i tatueshem	-
Shpenzime te tatimit mbi fitimin 15%	-
Tatim mbi fitimin i parapaguar	2,429,327
Totali per t'u paguar	-

Sipas legjislacionit fiskal shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin per vitin 2016 eshte 15%. Deklarimet tatimore plotesohen ne baze vjetore por fitimet ose humbjet e deklaruar per qellime tatimore mbeten te perkohshme deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat tatimore dhe regjistrimet e tatimpaguesve dhe leshojne nje vleresim perfundimtar.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

17. SHPENZIME TE PANJOHURA

Shpenzime te panjohura per periudhen 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016 analizohen si me poshte:

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
Shpenzime per personelin	3,659,628	-
Shpenzime udhetimesh	1,893,405	-
Gjoha dhe shpenzime interesi	310,021	2,205
Shpenzime akomodimi	100,544	670,658
Shpenzime provizione per gjoha tatimore	66,344	-
Shpenzime administrative	35,444	-
Shpenzime postare	16,464	-
Shpenzime transferimi	-	990,842
Totali	6,081,850	1,663,705

18. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
<i>Fonde te transferuar nga Shoqeria Meme:</i>		
Fonde te transferuara nga Brunel Energy Europe B.V.	259,027,570	51,405,209
Totali	259,027,570	51,405,209

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
<i>Detyrime ndaj paleve te lidhura:</i>		
Brunel Energy Europe BV	21,916,637	-
Brunel Italy S.r.l	1,051,808	-
Brunel Energy Holding BV	1,324,848	-
Totali	24,293,293	-

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
 Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
 31 dhjetor 2016
 (shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

18. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA (VAZHDIM)

	Per periudhen nga data 1 janar 2016 deri me 31 dhjetor 2016	Per periudhen nga data e themelimit 18 maj 2015 deri me 31 dhjetor 2015
<i>Shpenzime te marra nga palet e lidhura</i>		
Brunel Energy Europe BV	22,891,700	-
Brunel Italy S.r.l	1,056,708	-
Brunel Energy Holding BV	1,327,200	-
Totali	25,275,608	-
<i>Te arketueshme nga palet e lidhura</i>		
Brunel Italy S.r.l	312,438	-
Totali	312,438	-
<i>Te ardhura nga palet e lidhura</i>		
Brunel Italy S.r.l	315,326	-
Totali	315,326	-

19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Ky shenim permban informacion per ekspozimin e Deges ndaj rrezikut te kredise, rrezikut te likuiditetit dhe rrezikut te tregut. Rreziku i tregut perfshin rrezikun e normes se interesit dhe rrezikun e kurseve te kembimit.

Drejtimi ka pergjegjesi per ngritjen dhe kontrollin e nje plani te pergjithshem per manaxhimin e rrezikut.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016
(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredise

Me 31 dhjetor 2016 Dega nuk eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi i llogarive te arketueshme ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte i lidhur vetem me klientet vendas.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare perfaqeson nivelin maksimal te ekspozimit ndaj rrezikut te kredise. Niveli maksimal i ekspozimit ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari te arketueshme dhe kredi te tjera tatimore	19,612,639	672,297
Mjete monetare dhe ekuivalentet e e saj	270,862,211	128,955
Gjendja ne fund te periudhes	290,474,850	801,252

(b) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku qe ndryshimet ne çmimet e tregut, si normat e interesit, kurset e kembimit dhe çmimet e kapitalit do te ndikojne ne te ardhurat apo ne vleren e instrumenteve financiare te Deges. Objektivi i manaxhimit te rrezikut te tregut eshte manaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshem duke optimizuar kthimin.

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe Dega mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Rreziku i likuiditetit eshte rrezik i qenesishem ne biznesin e Deges pasi disa aktive te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Dega menaxhon rrezikun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhet me profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.

31 dhjetor 2016

	deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
Llogari te arketueshme dhe kredi te tjera tatimore te arketueshme	19,300,201	-	-	19,300,201
Mjete monetare ne banke	270,862,211	-	-	270,862,211
	290,162,412	-	-	290,162,412
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	(17,185,538)	(2,376,656)	(280,944,207)	(300,506,401)
	(17,185,538)	(2,376,656)	(280,944,207)	(300,506,401)
Rreziku i likuiditetit ne fund te periudhes	272,976,874	(2,376,656)	(280,944,207)	(10,343,990)

(d) Rreziku i valutes

Dega ndermerr transakcione ne monedhe te huaj si pasoje e ekspozimit ndaj luhatjeve te kursit te kembimit. Ekspozimi ndaj kurseve te kembimit manaxhohet duke percaktuar nje politike midis te arketueshmeve dhe pagueshmeve. Vlerat kontabel te aktiveve dhe detyrimeve monetare te Deges sipas monedhave per vitin qe u mbyll me 31 dhjetor 2016 jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per periudhen 1 janar 2016 deri me
31 dhjetor 2016

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(d) Rreziku i valutes (vazhdim)

31 dhjetor 2016	EUR	GBP	USD	LEK	Totali
Llogari te arketueshme dhe kredi tatimore	13,508,877	2,782,195	495,879	2,513,250	19,300,201
Mjete monetare ne banke	184,589,218	79,514,857	(128)	6,758,264	270,862,211
	198,098,095	82,297,052	495,751	9,271,514	290,162,412
Llogari te pagueshme dhe te tjera	(21,917,385)	(4,795,849)	-	(14,765,597)	(41,478,831)
Detyrime ndaj Shoqerise Meme	(149,004,666)	(105,323,440)	-	(4,699,464)	(259,027,570)
	(170,922,051)	(110,119,289)	-	(19,465,061)	(300,506,401)
Rreziku i kursit te kembimit me 31 dhjetor 2016	27,176,044	(27,822,238)	495,751	(10,193,547)	(10,343,990)

20. NGJARJE TE METEJSHME

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te metejshme pas dates se raportimit qe te kerkojne ndryshime apo rregullime te metejshme te pasqyrave financiare.

* * * * *

SHOQERIA: Brunel Energy Europe BV - Dege e shoqerise se huaj
NIPTI: L51816004Q

Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2016

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2016	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2016
1	Toka	-	-	-	-	-
2	Ndertime	-	-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegla	-	-	-	-	-
4	Mjete transporti	-	-	-	-	-
5	Pajisje Kompjuterike	-	-	-	-	-
6	Pajisje Zyre	-	-	-	-	-
7	Te tjera	-	-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Amortizimi A.A.Materiale 2016

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2016	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2016
1	Toka	-	-	-	-	-
2	Ndertime	-	-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegla	-	-	-	-	-
4	Mjete transporti	-	-	-	-	-
5	Pajisje Kompjuterike	-	-	-	-	-
6	Pajisje Zyre	-	-	-	-	-
7	Te tjera	-	-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2016

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2016	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2016
1	Toka	-	-	-	-	-
2	Ndertime	-	-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegla	-	-	-	-	-
4	Mjete transporti	-	-	-	-	-
5	Pajisje Kompjuterike	-	-	-	-	-
6	Pajisje Zyre	-	-	-	-	-
7	Te tjera	-	-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Administrator i Shoqerise

Brunel

access to excellence

Brunel Albanian Branch – Brunel Energy Europe B.V,
 Dege e Shoqerise se Huaj
 L51816004Q

Rruga "Elbasanit", Pallati nr.1, kati 2, Tirane, Shqiperi
 Albania
 ssc.europe@brunel.net

INVENTARI I MALLRAVE

31.12.2016

Subjekti

Brunel Energy Europe BV - Dege e shoqerise se huaj

NIPT-J

L51816004Q

Aktiviteti

Sherbime dhe keshillime per sipermarrjet industriale, vecanerisht sipermarrjet qe ushrojne veprimtari ne fushen e industrise se vajit dhe gazit, kimise, industrise petrokimike dhe industrise se energjise

Adresa Vep.

Rr "Elbasanit" Pl. nr. 1, kati 2, Tirane

Telefoni

-

Nr.	Artikulli	Nj/M	Sasia	Kosto/njesi	Vlera
-	-	-	-	-	-
Shuma					
			-	-	-

Administratori i Shoqerise

Brunel

access to excellence

Brunel Albanian Branch - Brunel Energy Europe B.V.
Dege e Shoqerise se Huaj
L51816004Q

Rruga "Elbasanit", Pallati nr.1, kati 2, Tirane, Shqiperi
Albania

ssc.europe@brunel.net

INVENTARI I AUTOMJETEVE NE PRONESI TE SUBJEKTTIT

31.12.2016

Subjekti

Brunel Energy Europe BV - Dege e shoqerise se huaj

NIPT-I

L51816004Q

Aktiviteti

Sherbime dhe keshillime per siper marrjet industriale, vecanerisht siper marrjet qe ushtrojne veprimtari ne fushen e industrise se vajit dhe gazit, kimise, industrise petrokimike dhe industrise se energjise

Adresa Vep.

Rr "Elbasanit" Pl. nr. 1, kati 2, Tirane

Telefoni

-

Nr.	Lloji Automjeteve	Kapacitet	Targa	Vlera
-	-	-	-	-
	Shuma			-

Administrator i Shoqerise



Brunel Albanian Branch - Brunel Energy Europe B.V.
Dege e Shoqerise se Huaj
L51816004Q

Rruga "Elbasanit", Pallati nr. 1, kati 2, Tirane, Shqiperi
Albania

ssc.europe@brunei.net